



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

PRISHTINË, 22 DHJETOR 2010
NR. REF.: AGJ 78/10

AKTGJYKIM

Rasti Nr. KO 97/10

Në çështjen e kërkesës së parashtruar nga Ushtruesi i Detyrës së Presidentit, Dr. Jakup Krasniqi, lidhur me mbajtjen e postit të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit dhe njëkohësisht të postit të Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Demokratike të Kosovës.

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Dr. Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit të Kosovës, i cili është Ushtrues i Detyrës të Presidentit të Kosovës.

Çështja e lëndës

2. Nëse Dr. Jakup Krasniqi si Ushtrues i Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës i ndalohet mbajtja dhe ushtrimi i postit të Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK).

Baza juridike

3. Neni 84 (9) i Kushtetutës së Kosovës (Kushtetuta), Neni 29 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese (Ligji) dhe Neni 55 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese (Rregullorja).

Procedura para Gjykatës

4. Duke pasur parasysh Aktgjykimin e 28 shtatorit 2010 të Gjykatës Kushtetuese në rastin “Naim Rrustemi dhe 31 deputetë të tjerë të Kuvendit të Kosovës dhe Shkëlqesia e tij, Prof. Dr. Fatmir Sejdiu”, me anë të një kërkesë të 13 tetorit 2010, të pranuar nga Gjykata më 14 tetor 2010, Ushtruesi i Detyrës së Presidentit të Kosovës kërkoi:
 - i. Nëse kufizimi “Pas zgjedhjes, Presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër në parti politike”, siç parashihet në Nenin 88.2 të Kushtetutës vlen edhe për Ushtruesin e Detyrës së Presidentit.
 - ii. Për më tepër, ai kërkoi “vlerësimin e kushtetutshmërisë së mbajtjes dhe ushtrimit të përkohshëm të funksioneve të Presidentit të Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht të ushtrimit të postit të Sekretarit të Përgjithshëm të PDK-së”.
5. Në bazë të Rregullores së punës, Kryetari i Gjykatës e caktoi Gjyqtaren Iliriana Islami si gjyqtare raportuese dhe i caktoi gjyqtarët Ivan Čukalović (kryesues), Enver Hasani (Kryetar) dhe Kadri Kryeziu (Zëvendëskryetar) si anëtarë të Kolegjit shqyrtues.

Faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës

6. Më 27 shtator 2010, Shkëlqesia e tij, Prof. Dr. Fatmir Sejdiu, President i Republikës së Kosovës shpalli publikisht dorëheqjen e tij nga posti i Presidentit të Kosovës, pas shpalljes së Aktgjykimit të shumicës së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese në rastin e ngritur kundër tij nga Naim Rrustemi dhe 31 deputetë të tjerë të Kuvendit të Kosovës.
7. Në atë rast, kjo Gjykatë kishte konstatuar me vendim të shumicës se ka pasur shkelje serioze të Kushtetutës së Kosovës, përkatësisht të Nenit 88.2, nga Shkëlqesia e tij, Prof. Dr. Fatmir Sejdiu, duke mbajtur njëkohësisht postin e Presidentit të Republikës dhe atë të Kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës.
8. Si Kryetar i Kuvendit, Dr. Krasniqi iu dhanë detyrat dhe funksionet e Presidentit të Republikës së Kosovës, në bazë të Nenit 90 të Kushtetutës, edhe pse gjatë gjithë kohës ai ka vazhduar dhe vazhdon ta mbajë dhe ushtrojë postin e Sekretarit të Përgjithshëm të PDK-së.
9. Ai kërkoi sqarim nëse kufizimi i sipërpërmendur vlen edhe për të sepse ai tani është Ushtrues i Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës.

Pranueshmëria

10. Ish-Presidenti Fatmir Sejdiu dha dorëheqje nga posti i tij më 27 shtator 2010 pas Vendimit të Gjykatës Kushtetuese në kërkesën e përmendur në paragrafin 6 më lart. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, parashtruesi i kërkesës, më pas u bë Ushtrues i Detyrës së Presidentit dhe ka kryer funksionet e Presidentit të Kosovës që nga ajo kohë.

11. Sipas Nenit 84 (9) të Kushtetutës, Presidenti “mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese”.
12. Çështjet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës janë “çështje kushtetuese”, siç parashihet në Nenin 84 (9) të Kushtetutës. Pra, çështje relevante kushtetuese është të sqarohet nëse hapat që Ushtruesi i Detyrës së Presidentit mund t'i ndërmarrë apo veprimet që mund të kërkojnë nga ai për t'i ndërmarrë përbëjnë shkelje serioze të Kushtetutës gjersa në të njëjtën kohë mban dhe ushtron edhe postin e Sekretarit të Përgjithshëm të PDK-së.
13. Çka përbën çështje kushtetuese është sqaruar nga kjo Gjykatë në rastin e “Kërkesës së Presidentit të Republikës së Kosovës për sqarim të kompetencave në rastin e kryetarit të Rahovecit”, Rasti Nr. KO 80/10. Gjykata shpalli Aktgjykimin e vet më 7 tetor 2010 lidhur me statusin e dorëheqjes së kryetarit të komunës. Faktet e përmendura në atë rast e siguruan Gjykatën se çështja ishte e një rëndësie të mjaftueshme për ta shpallur rastin të pranueshëm. Do të ketë, pa dyshim, edhe kërkesa të tjera, në kohë të duhur, për çështjet e parashtruara nga Presidentët ose Ushtruesit e Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës.
14. Është e vërtetë që duhet të ketë siguri kushtetuese lidhur me kompetencat e Ushtruesit të Detyrës së Presidentit. Kjo nuk është pyetje e lehtë për ta parashtruar para Gjykatës. Gjykata Kushtetuese e ka për detyrë t'u përgjigjet pyetjeve të tilla. Në përputhje me Nenin 112.1 të Kushtetutës, “*Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës*” dhe për shkak të kësaj, nuk ekziston asnjë organ tjetër nga i cili parashtruesi i kërkesës mund të kërkojë përgjigje në këto çështje kushtetuese. Gjykata është e mendimit se çështjet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës janë “çështje kushtetuese” të parapara në Nenin 84 (9) dhe që këto çështje të ngritura janë të përshtatshme për t'u shqyrtuar nga kjo Gjykatë.
15. Ushtruesi i Detyrës së Presidentit duhet të inkurajohet të konsultohet me organin e vetëm që është në gjendje t'i shqyrtojë çështjet kushtetuese, pra me Gjykatën Kushtetuese. Për këto arsye, kjo Gjykatë konstaton që parashtruesi ka pozitë ose kompetenca që të referojë çështje para Gjykatës.
16. Neni 84 (9) i Kushtetutës nuk parashikon ndonjë afat kohor brenda të cilit këto pyetje mund të referohen në Gjykatë. Prandaj, rezulton që të gjitha kriteret për pranueshmëri të kërkesës janë përmbushur.

Meritat

17. Ligji për Presidentin e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-094, u miratua më 19 dhjetor 2008 dhe u publikua në Gazetën Zyrtare më 25 janar 2009. Ky Ligj nuk përmend në asnjë mënyrë funksionin e Ushtruesit të Detyrës së Presidentit dhe prandaj nuk mund t'i ndihmojë Gjykatës që të merret me çështje të veçanta që i referohen Gjykatës.
18. Gjykata e analizoi funksionin e Presidentit të Republikës së Kosovës dhe përputhshmërinë e atij funksioni me ngrirjen/mbajtjen/ushtimin e postit të Kryetarit të LDK-së në Aktvendimin e vet për rastin e Presidentit Fatmir Sejdiu. Funksionet e Presidentit, siç parashihen në Kushtetutë, ishin ekzaminuar me kujdes në Aktgjykimin e vet. Nuk ka nevojë t'i theksojmë ato sërish. Gjykata konkludoi me shumicë votash se Presidenti Sejdiu kishte bërë shkelje serioze të Nenit 88.2 të Kushtetutës duke mbajtur të dy funksionet njëkohësisht.

19. Deputetët e Kuvendit të Kosovës e zgjedhin me votim të fshehtë Presidentin e Kosovës. Neni 86.1 thotë që *"Presidenti i Republikës së Kosovës do të zgjedhet nga Kuvendi me votim të fshehtë"*. Presidenti vepron si kreu i shtetit dhe ai ose ajo përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës. Parimi i demokracisë përfaqësuese që i mbështet institucionet dhe vendimmarrjen në Republikën e Kosovës u jep të drejtë përfaqësuesve të zgjedhur të qytetarëve që ta zgjedhin Presidentin. Afati kohor prej gjashtë muajve, i paraparë më Nenin 90 të Kushtetutës, përtej të cilit Ushtruesi i Detyrës së Presidentit nuk mund ta ushtrojë më postin e Presidentit ekziston për të siguruar që Kuvendi i Kosovës zgjedh se kush do ta mbajë atë post të rëndësishëm në emër të popullit të Kosovës.
20. Neni 90 i Kushtetutës parashikon që Kryetari i Kuvendit të Kosovës do të jetë Ushtrues i Detyrës së Presidentit. Kryetari i Kuvendit zgjedhet nga deputetët e Kuvendit, nga radhët e tyre. Neni 67 përcakton zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit dhe funksionet e tij/saj me sa vijon:

Neni 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve]

1. Kuvendi i Kosovës nga radhët e veta zgjedh Kryetarin dhe pesë (5) nënkryetarë.

2. Kryetari i Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar dhe zgjedhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.

3. Tre (3) nënkryetarët të propozuar nga tri grupet më të mëdha parlamentare, zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.

4. Dy (2) nënkryetarë përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kuvend dhe ata zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve. Njëri nënkryetar do të jetë nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vendet të rezervuara ose të garantuara të komunitetit Serb, dhe tjetri nënkryetar nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara nga komunitetet tjera që nuk janë shumicë.

5. Kryetari dhe nënkryetarët e Kuvendit shkarkohen me votën e shumicës prej dy të tretave (2/3) të numrit të përgjithshëm të deputetëve.

6. Kryetari dhe nënkryetarët formojnë Kryesinë e Kuvendit. Kryesia është përgjegjëse për funksionimin administrativ të Kuvendit në mënyrën e përcaktuar me Rregulloren e Punës të Kuvendit.

7. Kryetari i Kuvendit:

(1) përfaqëson Kuvendin;

(2) përcakton rendin e ditës, thërret dhe kryeson seancat;

(3) nënshkruan aktet e miratuara nga Kuvendi;

(4) ushtron edhe funksione të tjera, në bazë të kësaj Kushtetute dhe Rregullores së Punës të Kuvendit.

8. Në rast mungese ose pamundësie për të ushtruar funksionin, Kryetarin e Kuvendit e zëvendëson njëri nga nënkryetarët.

21. Funksionet e Kryetarit të Kuvendit siç parashihen në Nenin e sipërpërmendur kanë të bëjnë kryesisht me punët e brendshme të Kuvendit dhe nuk kanë aq shumë funksione dhe kompetenca substanciale të Presidentit të Republikës. Funksionet e tyre janë të ndryshme.
22. Deputetët e Kuvendit e zgjedhin Kryetarin e Kuvendit në zgjedhjet që janë plotësisht të ndara nga zgjedhja e Presidentit të Republikës. Neni 88 i Kushtetutës, në tërësinë e tij, siguron me sa vijon:

Neni 88 [Papajtueshmëria]

1. Presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër publik.

2. Pas zgjedhjes, Presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion në parti politike.

23. Vëmendje e veçantë u kushtohet fjalëve të Nenit 88.2, i cili ndalon ushtrimin e funksioneve në parti politike, por vetëm “Pas zgjedhjeve...”. Këto fjalë, në kuptimin e tyre të zakonshëm, lënë të kuptohet që ndalimi i ushtrimit të ndonjë funksioni në parti politike vlen për Presidentin e Republikës që është zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës. Dr. Jakup Krasniqi nuk është zgjedhur si President i Republikës së Kosovës. Ai është zgjedhur vetëm si Kryetar i Kuvendit të Kosovës. Nuk ekziston asnjë ndalim në Kushtetutë lidhur me ushtrimin e funksioneve në parti politike për Kryetarin e Kuvendit.
24. Do të ishte ekzagjerim i kuptimit të nocionit të ndalimit për të kërkuar që Kryetari i Kuvendit të pushonte së ushtruari ndonjë funksion në parti politike vetëm pse ai ose ajo do të bëhet Ushtrues i Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës sipas dispozitave të Kushtetutës. Prandaj, Gjykata konstaton që natyra e “ushtrimit të detyrës” së Presidentit, që tashmë mbahet nga Dr. Jakup Krasniqi, nuk e ndalon atë nga mbajtja dhe ushtrimi i postit të Sekretarit të Përgjithshëm të PDK-së. Ai e mban postin e Ushtruesit të Detyrës së Presidentit. Përgjegjësitë e atij funksioni dalin në përputhje me Kushtetutën dhe rrjedhin nga Kushtetuta.
25. Ushtruesi i Detyrës së Presidentit nuk është President i zgjedhur dhe herë pas here mund të ngrihen pyetje lidhur me kompetencat e Ushtruesit të Detyrës së Presidentit. Asnjë çështje e tillë nuk është ngritur në këtë kërkesë. Çështjet e tilla janë çështje kushtetuese dhe Gjykata do t'i shqyrtojë këto çështje kur të ballafaqohet me kërkesën e duhur, duke marrë parasysh parimin e ndarjes së pushteteve, siç përcaktohet në Nenin 4.1 të Kushtetutës, dhe do të ketë kujdes të mos ndërhyjë në sferat e degëve të tjera të qeverisë.

PER KETO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në seancën e datës 22 dhjetor 2010:

VENDOS

- I. Kërkesa është e pranueshme;
- II. Nuk ka ndalim për Ushtruesin e Detyrës së Presidentit për ushtrimin e funksioneve në parti politike të cekura në Nenin 88.2 të Kushtetutës;

- III. Mbajtja dhe ushtrimi i përkohshëm i funksioneve të Presidentit të Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht ushtrimi i postit të Sekretarit të Përgjithshëm të PDK-së nuk është në papajtueshmëri me Kushtetutën;
- IV. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me Nenin 20(4) të Ligjit; dhe
- V. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Dr. Iliriana Islami, d.v.



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani, d.v.